



## Informacione për vetë-testin e koronavirusit

Versioni: 28 qershor 2021

Ju keni blerë një vetë-test për koronavirusin në farmacinë tonë. Ne ju lutemi që t'i kushtoni vëmendje këshillave të rëndësishme të listuara më poshtë. **Vetë-testi nuk zëvendëson rregullat e higjienës, distancës dhe sjelljes dhe i koncepteve ekzistuese të mbrojtjes.**

### Çfarë duhet pasur parasysh në lidhje me përdorimin e vetë-testit?

Vetë-testet përkundrejt testeve PCR kanë një shkallë të qartë të ulët të njohjes dhe prandaj janë më pak informuese – në veçanti te personat pa simptoma.

<b>Kur bën sens përdorimi i një vetë-testi?</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Në rastin e personave pa simptoma dhe pa kontakt në rastet me Covid-19, të cilët dëshirojnë të kryejnë një test në shtëpi.</li><li>Në rastin e personave që nuk janë vaksinuar (ende) ose janë shëruar.</li></ul>
<b>Kur nuk duhet të bëhet një vetë-test?</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Vetë-testi nuk duhet të bëhet në rastin e personave, të cilët kanë simptomat e sëmundjes. Këta duhet të kryejnë një test PCR ose testin e shpejtë të antigjenit në një spital, një klinikë mjekësore, një qendër testimi ose një farmaci.</li><li>Mos kryeni një vetë-test para një vizite te personat që rrezikohen shumë dhe institucionet shëndetësore.</li><li>Mos kryeni një vetë-test në rastin e testeve të përsëritura në shkolla, ndërmarrje dhe institucione.</li></ul>
<b>Ku mund të sigurohen vetë-testet?</b>	Dhënia e vetë-testeve kryhet falas në Zvicër në farmaci në kushte të caktuara. Vetë-testet mund të merren në pikat e shitjes kundrejt një page.
<b>Kush paguan për vetë-testet?</b>	Konfederata merr përsipër shpenzimet, jo sigurimet shëndetësore. Prandaj ju nuk jeni i detyruar të paguani asgjë vetë.
<b>Sa vetë-teste lejohen të merren në farmaci?</b>	Konfederata merr përsipër shpenzimet për <b>maksimumi 5 vetë-teste për çdo person brenda 30 ditëve</b> , sapo ato dorëzohen nga farmacia. <a href="#">Kjo vlen për personat, të cilët as nuk janë vaksinuar as nuk janë shëruar.</a> Të gjithë personat e tjerë mund të marrin vetë-teste me kosto vetjake.
<b>Kur konsiderohesh i shëruar ose i vaksinuar?</b>	Si i vaksinuar plotësisht konsiderohesh, nëse doza e dytë e vaksinës është bërë më pak se 365 ditë <sup>1</sup> . Si të shëruar plotësisht konsiderohen tashmë të vaksinuarit pas një doze të vaksinës. Pas infektimit me Sars-CoV-2 që ka kaluar, konsiderohesh si i shëruar, nëse rezultati i testit PCR ka dalë pozitiv të paktën pas 11 ditësh, por jo më shumë se 6 muaj.
<b>A lejohem unë të marr në farmaci vetë-teste për persona të tjerë (p.sh. pjesëtarë të familjes)?</b>	Për sa kohë ju posedoni kartën e sigurimeve shëndetësore, kjo gjë është e mundur. Sidoqoftë, faturimi kryhet për çdo person individual të siguruar (nuk bëhet një përmbledhje për të gjithë familjen).
<b>Si ta përdor unë vetë-testin në mënyrë të saktë?</b>	Përdorimi është përshkruar në fletën informuese që gjendet Me kodin QR që gjendet këtu mund të shihni një video shpjeguese.
<b>Rezultati im i vetë-testit është pozitiv</b> Çfarë duhet bërë?	<p>➔ <b>Rezultati duhet konfirmuar menjëherë (&lt;72 orë) nëpërmjet një testi PCR. Ky test PCR i konfirmuar është falas.</b></p> <p>Ju lutemi testohuni menjëherë. Kodi QR: Ku mund të testohem?</p> <p>➔ <b>Ju lutemi vetë-izolohuni</b> deri në marrjen e rezultatit konfirmues PCR.</p>



<sup>1</sup> në rastin e vaksinës Janssen kohëzgjatja është 365 ditë nga dita e 22-të pas vaksinimit.

**Rezultati im i vetë-testit është negativ**

Çfarë duhet bërë?

- ➔ Vazhdoni të respektoni rregullat e higjienës, distancës dhe sjelljes së Autoritetit Federal të Shëndetit (BAG).
- ➔ Rezultati juaj i testit është i vlefshëm vetëm ditën e testit. Në rast se keni simptoma testohuni në një spital, një klinikë mjekësore, një qendër testimi ose një farmaci. Informohuni në faqen informuese të koronës të kantonit tuaj.

Në rastin e pyetjeve ose paqartësive farmacia juaj është aty për ju.

Vula e farmacisë

## Ftesë për pjesëmarrjen në një pyetësor për vetë-testin e koronavirusit

Ju keni marrë një vetë-test për koronavirusin. Shoqata Zvicerane e Farmacistëve pharmaSuisse dëshiron të dijë nga ju, se si e përjetoni dhënien e vetë-testeve në farmaci dhe si i përdorni vetë-testet. Në këtë mënyrë ju ndihmoni, për të përmirësuar këtë shërbim.

Të gjithë personat në Zvicër që kanë bërë tashmë një vetë-test për koronavirusin mund të marrin pjesë. Pyetësori është i disponueshëm në katër gjuhë (gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe anglisht).

Përgjigjuni pyetjeve online.  
Kjo zgjat vetëm 5-7 minuta.

**Nuk ka përgjigje të sakta ose të gabuara.**

Për më tepër skanoni kodin e treguar QR ose kopjoni URL e mëposhtme:

<https://findmind.ch/c/iCvStD>



Ju vendosni në mënyrë vullnetare, nëse doni të merrni pjesë ose jo në këtë pyetësor. Përgjigjet tuaja janë anonime dhe ruhen dhe përpunohen në serverët e cyon GmbH në Bazel (CH). Nuk ruhet ose nuk vlerësohet asnjë e dhënë personale. Për një interpretim të ndodhive ne kërkojmë vetëm informacione të përgjithshme për personin tuaj si gjinia, moshën ose kantonin tuaj. Këto të dhëna nuk lejojnë asnjë përfundim për personin tuaj.

Shumë faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!